



**STATUTI I SHOQERISE**  
**“ALBANIA BEG AMBIENT” SH.P.K.**

Ne baze te ligjit 7638, date 19.11.1992, “Per shoqerite tregtare”, dhe ligjit 7667 date 28.1.1993 “Per Regjistrin Tregtar”, ne te nenshkruarit shpallim si me poshte vijon:

**FORMIMI I SHOQERISE**  
**Neni 1**

Miratohet statuti i ri i shoqerise se quajtur “ALBANIA BEG AMBIENT” SH.P.K. me ortake:

1. Shoqeria “BEG” sha, person juridik Italian, e regjistruar ne Dhomen e Tregetise, Industrise, Artizanatit dhe Bujqesise se Romes me nr. regjistri 7165/95, e perfaqesuar nga Presidenti i saj Z. Francesco Becchetti;
2. Soqeria “ENERGJI” SHPK, person jurdik shqiptar, e regjistruar me vendimin nr. 30688, date 18.12.2003 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, perfaqesuar nga administratori i saj Z. Andi Kondi;
3. Shoqeria “CO.LA.RI” Konsorciumi Lacial i Mbeturinave, person juridik italian, i regjistruar ne Dhomen e Tregetise, Industrise, Artizanatit dhe Bujqesise se Romes me nr. regjistri 06725630583/96, i perfaqesuar nga Presidenti i saj Avv. Manlio Ceroni.

**SELIA E SHOQERISE**  
**Neni 2**

Selia zyrtare e Shoqerise ndodhet ne adresen: Rruga “Deshmoret e Kater Shkurtit” Nr. 2, ap 30, Tirane, Shqiperi. Shoqeria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithë territorin e Republikes se Shqiperise.

**KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE EKONOMIKE**  
**Neni 3**

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise eshte e pakufizuar mbi 20 vjet dhe fillon qe prej dates se regjistrimit te saj ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane.

## OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

### Neni 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte si me poshte:

- Shoqeria do te realizoje dhe administroje impiantet hidroelektrike te Kalivaçit, Kaludhit, Dragotit, Karbunares dhe Skavices;
  - Zhvillimi i aktivitetit projektues, ndertimi, mirembajtja dhe drejtimi i impianteve, veprave publike ne pergjithesi;
  - Zhvillimi i aktivitetit te prodhimit dhe shitjes se aparaturave, aktivitetit te kerkimit, konsulences dhe asistences; si edhe te aktivitetit te blerjes, tregimit dhe trading te mirave dhe sherbimeve, aktivitete qe i referohen sektoreve qe vijojne A), B), C), D):
- A) Ne sektorin e energjise elektrike ku perfshihen aktivitetet e prodhimit, importimit dhe eksportimit, shperndarjes dhe shitjes, ashtu si dhe transferimit ne kufijte e normativave ne fuqi;
  - B) Ne sektorin energjitik ne pergjithesi, duke perfshire edhe lendet e djegeshme;
  - C) Ne sektorin e ambjentit;
  - D) Ne sektorin hidrik.
- Per ndjekjen e objektit social shoqeria gjithashtu mund te kryeje te gjitha veprimet qe do te jene te domosdoshme apo te nevojeshme qe lidhen me thjeshtesimin:
  - a) Prezenca e garancive reale dhe/ose personale per detyrime vetjake ose te treteve, veprime me pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme, veprime tregtare, dhe te tjera lidhur me objektin social.

### Neni 5

Kjo shoqeri mund te ndryshoje emertimin e saj, vendqendrimin, objektin e aktivitetit, te shtoje ortake, te rrise kapitalin sipas vendimeve te asamblese se ortakeve.

## KAPITALI I SHOQERISE

### Neni 6

Kapitali fillestar i shoqerise eshte 1.000.000 leke dhe i ndare ne kuota me te njejten vlere por asnjehere me e vogel se 1.000 lekë. Çdo ortak ka te drejten e votës. Kuotat qe jane me te medha se 1.000 lekë i japin te drejten e nje vote per cdo 1.000 lekë.

Kontributi i ortakeve ne kapitalin themeltar eshte si me poshte:

1. Shoqeria "BEG" SHA, e cila zoteron 70% te kapitalit fillestar te shoqerise.
2. Shoqeria "ENERGJI", e cila zoteron 20% te kapitalit fillestar te shoqerise.
3. Shoqeria "CO.LA.RI", e cila zoteron 10% te kapitalit te shoqerise.

### Neni 7



Ky kapital mund te shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit te te gjithë ortakeve.

## **DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI**

### **Neni 8**

Shoqeria tregtare deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe permban ky Statut si dhe te legjislacionit shqiptar ne fuqi. Ajo konsiderohet e krijuar ne daten e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar ne Gjykatën e Rrethit Tirane dhe pasi te marre licensen perkatese nga organi perkates tatimor.

### **Neni 9**

Ortakët e shoqerise me krijimin e kesaj shoqerie pjesen e kapitalit te derdhur prej tyre nuk mund ta terheqin. Kjo mund te behet vetem pasi te nxirret bilanci i shoqerise per fitimin e realizuar.

### **Neni 10**

Kuotat e çdo anetari perputhen me pjesen e tyre ne kapitalin e shoqerise. Kuotat e tij anetari i shoqerise mund t'ua ofroje te treteve. Anetaret e shoqerise kane perparesi per blerjen e kuotave perpara personave te trete jashte shoqerise. Ortaku qe deshiron te transferoje ose te shese kuotat e tij i drejton nje kerkese me shkrim Organit Administrativ duke saktësuar çmimin e shitjes, i cili duhet te jete i arsyeshem dhe te jete i njejte me ate qe do t'i ofrohet dhe nje personi te trete jashte shoqerise si dhe te dhenat e bleresit. Organi administrativ jep pergjigje brenda 30 diteve nga data e njoftimit dhe duhet t'ua transmetoje ortakeve te tjere kete kerkese te cilet duhet te japin nje pergjigje brenda 3 muajve. Edhe e drejta e perparesise per transferimin ose shitjen e kuotave duhet te ushtrohet me shkrim duke ju drejtuar Organit Administrativ.

E drejta e perparesise per transferimin ose shitjen e kuotave eshte ne proporcion me kuotat qe zoteron secili prej ortakeve ne kete shoqeri. Organi Administrativ pasi ka kaluar afati prej 3 muajsh, brenda 30 diteve i komunikon ortakut qe shet kuotat e tij vendimin e ortakeve te tjere per te blere te gjitha ose pjeserisht kuotat e tij. Ne rast se kuotat nuk shiten brenda shoqerise, atehere keto kuota brenda 90 diteve i ofrohen personave te trete jashte shoqerise. Transferimi dhe shitja e kuotave duhet te behen me akte noteriale dhe nje kopje e ketij akti duhet te depozitohet ne librin e Ortakeve.

Po keshtu transferimi i kuotave ne rruge trashegimie behet sipas neneve 46, 47, 49 te ligjit 7638 date 19.11.1992. Te gjitha transferimet kane efekt mbi shoqerine qe nga momenti i regjistrimit ne librin e Ortakeve. Kuotat prej 1.000 leke jane te pandashme. Ne rastet e bashkepronesise veprohet sipas ligjeve.



## Neni 11

Emertimi i shoqerise tregtare, kapitali themeltar, emrat e administratoreve, si dhe emrat e Ortakeve duhet te jene te permendura ne te gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqeri dhe qe iu drejtohen te treteve. Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme dhe me permbajtjen perreth saj.



## Neni 12

Shoqeria vepron nen regjimin e prones private dhe merr persiper vete te drejtat dhe detyrimet kontraktore dhe jashtekontraktore. Ortaket e shoqerise drejtojne procesin per zhvillimin e aktivitetit te shoqerise si dhe per detyrimet qe ka shoqeria ndaj te treteve pa asnje kufizim.

Organet e shoqerise jane:

- 1- Asambleja e Ortakeve.
- 2- Keshilli Administrativ.

## ASAMBLEJA E ORTAKEVE

### Neni 13

Organi me i larte i shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve e cila mblidhet nga çdo anetar i shoqerise qe perfaqeson te pakten 10% te kapitalit te shoqerise. Antaret duhet te njoftohen 15 dite perpara dhe ne lajmerim duhet te jete shkruar vendi, ora dhe ceshtjet qe do te trajtohen.

Neqoftese Asambleja nuk eshte mbledhur sipas rregullave te caktuara ajo mund te marre vendim kur çdo anetar i shoqerise eshte prezent dhe nuk kundersizton mbledhjen e Asamblese.

Çdo anetar i shoqerise ka te drejte te vere ne rendin e dites problemin qe ai deshiron. Per kete duhet te informohen anetaret 3 dite perpara.

## TE DREJTAT DHE KOMPETENCAT E ASAMBLESE

### Neni 14

Asambleja eshte e zakonshme dhe e jashtezakonshme.

1) **Asambleja e Zakonshme:** Mblidhet te pakten 1 here ne vit, brenda 4 muajve nga dita e mbylljes se veprimtarise. Ne kushte te vecanta Asambleja e zakonshme mund te mblidhet dhe brenda 6 muajve nga dita e mbylljes se veprimtarise se shoqerise.

Asambleja e zakonshme e ortakeve merr vendime te vlefshme si me poshte:

- a) Ne thirrjen e pare ne pranine e ortakeve qe jane vete prezent ose te perfaqesuar nga persona te trete me prokure te posacme dhe qe zoterojne me shume se gjysmen e pjeseve te kapitalit themeltar.
- b) Ne rast se nuk sigurohet kjo shumice, ne mbledhjen e dyte vendimet merren me shumicen e votave te dhena pavaresisht nga perqindja e kapitalit qe ato perfaqesojne.

Kompetencat e asamblese se Zakonshme:

Asambleja e Zakonshme e ortakeve ka kompetencat e meposhteme:

- Ajo emerom administratoret, zevendesin, ekspertet dhe revizoret kontabel.
- Ajo aprovon çdo lloj veprimi financiar qe me ligj dhe me marreveshje lihet ne kompetence te Asamblese.
- Percakton shperblimin per administratoret, ekspertet, revizoret kontabel.
- Ben lidhjen e kontratave per dhenie dhe marrje te drejtash ose ekskluzivitet per tregtimin dhe prodhimin e mallrave te shoqerise si dhe kontrata ne lidhje me organet shteterore per pjesmarrjen ne tender, ankande ose aktivite te tjera te rendesishme.
- Miraton marreveshjet midis shoqerise dhe nje prej administratoreve ose ortakeve te saj.
- Ka te drejte te miratoje bilancin e shoqerise dhe te beje ndarjen e fitimit.
- Vendors edhe per cdo ceshtje tjeter qe nuk sjell ndryshime ne statutin e shoqerise.

2) **Asambleja e Jashtezakonshme:** Thirret kur Organi Administrativ e sheh te arsyeshme ose kur kerkohet nga ortaket qe perfaqesojne 10% te kapitalit te shoqerise. Ne kete rast Organi Administrativ ka te drejte te vendose ditin e mbledhjes jo me larg se 15 dite nga dita e kerkeses.

Ne mbledhjen e Asamblese se Jashtezakonshme vendimet do te jene te vlefshme ne rast se ato do te merren nga ortaket qe perfaqesojne te pakten  $\frac{3}{4}$  (tre te katertat) e pjeseve te kapitalit themeltar.

Asambleja e jashtezakonshme e ortakeve ka kompetencat e meposhtme:

- Te marre ne shqyrtim dhe ka te drejte te miratoje te gjitha ndryshimet e statudit.
- Ajo ka te drejte te beje perjashtimin e nje ortaku nga shoqeria per rastet e parashikuara ne ligj si dhe ne rregulloren e brendshme te shoqerise.
- Ben transferimin e kuotave te te tretet.
- Si dhe çdo ceshtje tjeter qe nuk eshte ne kompetencen e Asamblese se Zakonshme.
- Realizon blerjen, shitjen dhe transferimin e pasurive te paluajtshme te shoqerise etj.
- Vendors ne lidhje me çdo ceshtje te lidhur me pasurine e shoqerise, shitjet dhe blerjet nepermjet hipotekes, kredise, etj.



- Vendos pjesemarrjen ne shoqeri te tjera.

### Neni 15

Kur pjesemarrja ne asamble eshte normale vendimet qe merren brenda kufijve te kontrates se themelimit, Statutit e te ligjeve jane te detyrueshme per te gjithë, edhe per ata qe nuk kane marre pjese ne diskutim edhe per ata qe nuk jane dakord.

Cdo ortak mund te perfaqesohet nga nje ortak tjeter qe nuk eshte administrator. Asnje i derguar nuk mund te perfaqesoje me shume se nje ortak.

Ne Asamblene e Ortakeve marrin pjese nese eshte e nevojshme per te dhene mendim eksperte, revizore etj.

### Neni 16

Marrja e vendimeve te Asamblese, mbajtja e procesverbaleve dhe te gjitha dokumentat e tjera qe kane te bejne me te duhet te behen sipas legjislacionit ne fuqi per kete qellim.

## ADMINISTRIMI

### Neni 17

Shoqeria administrohet nga 3 deri ne 7 administratore qe perbejne Keshillin Administrativ i cilei caktohet ne statutin e shoqerise dhe me pas nga Asambleja e Ortakeve. Administratoret qendrojne ne detyre per nje periudhe 3 vjeçare, jane te riemerueshem, dhe ne rast se gjate kesaj periudhe shfaqen probleme paaftesie nga ana e secilit prej tyre, Asambleja e Ortakeve vendos shkarkimin e administratorit perkates duke treguar me fakte demin qe i eshte shkaktuar shoqerise nga paaftesia e tij pasi eshte dhene mendimi per kete dem nga specialistet perkates.

Keshilli Administrativ ka te gjitha kompetencat per te vepruar me te tretet ne emer te shoqerise dhe ne interes te saj ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji dhe Statuti i shoqerise u'a jep shprehimisht ortakeve.

Keshilli Administrativ ka te drejte qe te gjitha kompetencat e permendura me siper t'i ushtrojne se bashku apo veç e veç duke qene pergjegjes individualisht ose solidarisht, sipas rastit, ndaj shoqerise apo te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Administratoreve nuk u lejohet te kontraktojne ne çfaredo lloj forme, te marrin hua tek shoqeria, te japin pelqimin ne emer te saj, per paradhenie si dhe te behen dorezanes apo te garantojne ne emer te saj angazhimet ndaj te treteve.



Keshilli zgjedh mes anetareve te tij:

- Nje President te cilit i rezervohet firma dhe perfaqesimi ligjgjor ne gjykim i shoqerise;
- Nje Administrator te Deleguar te cilit i rezervohet pervec firmes dhe perfaqesimit ligjgjor te shoqerise ndaj te treteve dhe ne gjykim fuqite ne vijim: drejtimi i veprimtarise se shoqerise, perfaqesimi i shoqerise ndaj te treteve, nenshkrimi i kontratave per sherbime furnizimi, propozimi i realizimit te projekteve te reja sociale, pergatitja dhe mbajtja e kontabilitetit, permbushja e te gjitha veprimeve bankare te nevojshme dhe sidoqofte te gjitha fuqite e administrimit te zakonshem.

Keshilli Administrativ therritet te pakten 5 dite me pare nepermjet faxit dhe ne raste urgjence ky afat mund te ulet deri ne 3 dite. Vendos me shumicen e te pranishmeve dhe shperndahet me doreheqjen e Administratorit te Deleguar ose me doreheqjen e te pakten dy keshilltareve.

Asambleja mund te vendose lejimin e nje shperblimi ne favor te Administratorit per kryerjen e detyres pervec pagimit te shpenzimeve.

Aktualisht Administratore te shoqerise jane:

- Z. Vilson Ahmenti President, shtetas shqiptar, lindur ne Fier, me 05.09.1951, banues Tirane, Rr. "Vaso Pasha" 14/23, me zotesi te plote juridike per te vepruar;
- Z. Francesco Becchetti Administrator i Deleguar, shtetas italian, lindur ne Rome, me 31.08.1966, banues per detyren ne Rome, Piazza di Spagna 66, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar;
- Z. Manlio Ceroni Keshilltar, shtetas italian, lindur ne Pisoniano (Roma), me 18.11.1926, banues per detyren ne Rome, Via del Poggio Fiorito 63, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.
- Z. Andi Kondi Keshilltar, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane, me 27.05.1971, banues per detyren ne Tirane, Rr. "Deshmoret e Kater Shkurtit" n. 5, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.

### Neni 18

Keshilli Administrativ mund te emeruje nje ose me shume drejtore per te kryer veprime te vecanta duke percaktuar fuqine e tyre brenda kufijve e duke e respektuar Statutin dhe ligjet ne fuqi dhe vendose dhenien e nje shperblimi ne favor. Detyrat e tyre do te percaktohen ne nje rregullore te brendshme te shoqerise.

### Neni 19

Keshilli Administrativ ka liri te plote per drejtimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te shoqerise dhe mund te kryeje te gjitha llojet e veprimeve dhe çdo lloj marreveshje per realizimin e qellimeve te shoqerise duke perjashtuar rastet qe jane te parashikuara ne ligj



dhe ne Statut qe i takojne Asamblese se Ortakeve.

#### **Neni 20**

Administratori i Deleguar ka te drejte te nenshkruajne per shoqerine, kontrata te ndryshme, per furnizime publike private, te ndermarre veprime gjyqesore per dhe ne emer te shoqerise, etj. Keshilli mund te jape prokura ne kufijte qe i lejon Asambleja e Ortakeve per kategori te caktuara veprimesh.

Administratoret jane te detyruar te mbajne regjistrat e magazinimit te cilet vihen ne dispozicion te Zyres Doganore per te mundesuar kryerjen e kontrolleve prej saj. Administratoret e shoqerise jane te detyruar te mbajne inventare te rregullta nje here ne muaj. Raporti i administrimit, inventari dhe llogarite vjetore, hartohen nga Administratoret.

#### **PJESMARRJA NE VENDIME**

##### **Neni 21**

Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne vendime si dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron.

Nje ortak mund te perfaqesohet nga nje ortak ose nga nje person tjetër me prokure te posacme.

#### **ZGJIDHJA E MOSMARREVEESHJEVE**

##### **Neni 22**

Ortakët e shoqerise do ti zgjidhin te gjitha mosmarreveshjet e tyre qe kane lidhje me shoqerine dhe aktivitetin e saj me mirekuptim midis njeri-tjetrit. Ne rast se nuk arrijne ti zgjidhin mosmarreveshjet e tyre me mirekuptim atehere ata do ti referohen Qendres Shqiptare te Ndermjetesimit dhe Arbitrazhit per zgjidhje me arbitrazh, me nje gjykate arbitrazhi te perbere nga tre arbitra, sipas rregullave dhe procedurave te kesaj Qendre. Secila nga palet do te zgjedhe nje arbitër. Ortakët bien dakorte qe arbitri i trete cili do te jete dhe Kryetari i Trupit arbitral te jete Av. Enyal Shuke. Ne rast se ndonjera nga palet nuk arrin ta zgjedhe arbitrin e saj brenda 15 diteve nga kerkesa per arbitrazh, ai do te emerohet nga Qendra. Ligji I zbatueshem do te jete ai shqiptar. Vendi ku do te zhvillohet arbitrazhi do te jete ne Tirane .

#### **MARREDHENIET E PUNES**

##### **Neni 23**

Mardheniet e punes rregullohen nepermjet kontrates se punes dhe legjislacionit te punes





ne fuqi. Shoqeria private merr persiper te respektoje rregullat ne fuqi te punesimit dhe te punesuarit jane te detyruar qe te respektojne Statutin e kesaj shoqerie dhe rregullat e brendeshme te saj. Te punesuarit duhet te pergjigjen per demet qe i shkaktojne kesaj shoqerie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

### **KONFIDENCIALITETI, RUAJTJA E SEKRETIT**

#### **Neni 24**

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike permbajtja e tyre per te tretet e te gjitha akteve dhe dokumentave qe jane percaktuar si te tilla nga administratoret e kesaj shoqerie.

### **EKSPERTET OSE REVIZORET KONTABEL**

#### **Neni 25**

Kontrolli mbi veprimtarine e Administratorit, veprimtarine e tij si dhe gjithe aktivitetin e shoqerise i besohet nje eksperti ose revizori kontabel. Ky ekspert do te qendroje ne detyre per aq sa percaktohet me ligj dhe mund te rizgjidhet. Asambleja e Ortakeve cakton dhe shperblimin perkates kur nuk ka norma te vecanta ligjore.

### **BILANCI DHE FITIMET**

#### **Neni 26**

Veprimtaria ekonomike e shoqerise do te mbyllet ne date 31 Dhjetor te çdo viti. Administratori merr masa per hartimin e bilancit dhe rezultatin ekonomik fitim - humbje dhe inventar. Pasi vecohen fondet si me siper dhe paguhen detyrimet fiskale, te ardhurat qe mbeten ndahen midis ortakeve dhe mund te transferohen lirisht jashte shtetit sipas dispozitave perkatese ligjore.

#### **Neni 27**

Ne rast se kapitali i shoqerise per shkak te humbjeve te realizuara rezulton me pak se kapitali themeltar, pronaret vendosin brenda 4 muajve per mundesine e prishjes se shoqerise.

### **SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE**

#### **Neni 28**

Ne rast se shoqeria priset per çdo lloj aresye Asambleja e Ortakeve percakton menyren e likuidimit, emeron nje ose me teper likuidatore dhe pergatit te gjitha dokumentet e nevojshme per ç' regjistrimin e saj nga Regjistri Tregtar.



**LIBRAT E SHOQERISE**  
**Neni 29**

Po keshtu shoqeria ne baze te ligjit mban librat e meposhtem:

- 1) Libri i Ortakeve
- 2) Libri i Mbledhjeve
- 3) Libri i vendimeve te administratorit
- 4) Libri i mbledhjeve dhe vendimeve te eksperteve ose revizoreve kontabel.

Librat e mesiperm duhet te jene te ruajtura per 10 vjet e cdo faqe duhet te jete e vulosur.




**DISPOZITA TE PERGJITHSHME**  
**Neni 30**


Persa eshte shprehur ne kete statut i referohemi ligjit 7638 dt 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare", Statutit dhe rregullores se brendshme te shoqerise. Çdo ndryshim behet ne te njejten menyre sic eshte nxjerre ky Statut dhe nuk prek personalitetin juridik te kesaj shoqerie.

**ORTAKET**

**"BEG" SPA**  
Francesco Becchetti



**"CO.LA.RI "**  
Per/ Avv. Manlio Cerroni  
Francesco Becchetti



**"ENERGJI " shpk**  
Andi Kondi



**STATUTI I SHOQERISE**  
**“ALBANIA BEG AMBIENT” SH.P.K.**

Ne baze te ligjit 7638, date 19.11.1992, “Per shoqerite tregtare”, dhe ligjit 7667 date 28.1.1993 “Per Regjistrin Tregtar”, ne te nenshkuarit shpallim si me poshte vijon:

**FORMIMI I SHOQERISE**

**Neni 1**

Miratohet statuti i ri i shoqerise se quajtur “ALBANIA BEG AMBIENT” SH.P.K. me ortake:

Shoqeria “BEG” sha, person juridik Italian, e regjistruar ne Dhomen e Tregetise, Industrise, Artizanatit dhe Bujqesise se Romes me nr. regjistri 7165/95, e perfaqesuar nga Presidenti i saj Z. Francesco Becchetti;

Soqeria “ENERGJI” SHPK, person juridik shqiptar, e regjistruar me vendimin nr. 30688, date 18.12.2003 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, perfaqesuar nga administratori i saj Z. Andi Kondi;

Shoqeria “CO.LA.RI” Konsorciumi Lacial i Mbeturinave, person juridik italian, i regjistruar ne Dhomen e Tregetise, Industrise, Artizanatit dhe Bujqesise se Romes me nr. regjistri 06725630583/96, i perfaqesuar nga Presidenti i saj Avv. Manlio Cerroni.

**SELIA E SHOQERISE**

**Neni 2**

Selia zyrtare e Shoqerise ndodhet ne adresen: Rruga “Deshmoret e Kater Shkurtit” Nr. 2, ap 30, Tirane, Shqiperi. Shoqeria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.

**KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE EKONOMIKE**

**Neni 3**

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise eshte e pakufizuar mbi 20 vjet dhe fillon qe prej dates se regjistrimit te saj ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane.

**OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE**

**Neni 4**

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte si me poshte:

Shoqeria do te realizoje dhe administroje impiantet hidroelektrike te Kalivaçit, Kaludhit, Dragotit, Karbunares dhe Skavices;

Zhvillimi i aktivitetit projektues, ndertimi, mirembajtja dhe drejtimi i impianteve, veprave publike ne pergjithesi;

Zhvillimi i aktivitetit te prodhimit dhe shitjes se aparaturave, aktivitetit te kerkimit, konsulences dhe asistences; si edhe te aktivitetit te blerjes, tregetimit dhe trading te te mirave dhe sherbimeve, aktivitete qe i referohen sektoreve qe vijojne A), B), C), D):

Ne sektorin e energjise elektrike ku perfshihen aktivitetet e prodhimit, importimit dhe eksportimit, shperndarjes dhe shitjes, ashtu si dhe transferimit ne kufijte e normativave ne fuqi;

Ne sektorin energjitik ne pergjithesi, duke perfshire edhe lendet e djegeshme;

Ne sektorin e ambientit;

Ne sektorin hidrik.

Per ndjekjen e objektit social shoqeria gjithashtu mund te kryeje te gjitha veprimet qe do te jene te domosdoshme apo te nevojeshme qe lidhen me thjeshtesimin:

a) Prezenca e garancive reale dhe/ose personale per detyrime vetjake ose te treteve, veprime me pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme, veprime tregtare, dhe te tjera lidhur me objektin social.

#### **Neni 5**

Kjo shoqeri mund te ndryshoje emertimin e saj, vendqendrimin, objektin e aktivitetit, te shtoje ortake, te rrise kapitalin sipas vendimeve te asamblese se ortakeve.

### **KAPITALI I SHOQERISE**

#### **Neni 6**

Kapitali fillestar i shoqerise është 1.000.000 leke dhe i ndarë në kuota me te njejten vlere por asnjëherë më e vogël se 1.000 lekë. Çdo ortak ka të drejtën e votës. Kuotat që janë më të mëdha se 1.000 lekë i japin të drejtën e një vote për cdo 1.000 lekë.

Kontributi i ortakeve ne kapitalin themeltar eshte si me poshte:

Shoqeria "BEG" SHA, e cila zoteron 70% te kapitalit fillestar te shoqerise.

Shoqeria "ENERGJI", e cila zoteron 20% te kapitalit fillestar te shoqerise.

Shoqeria "CO.LA.RI", e cila zoteron 10% te kapitalit te shoqerise.

#### **Neni 7**

Ky kapital mund te shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit te te gjithë ortakeve.

### **DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI**

#### **Neni 8**

Shoqeria tregtare deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe permban ky Statut si dhe te legjislacionit shqiptar ne fuqi. Ajo konsiderohet e krijuar ne daten e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar ne Gjykatën e Rrethit Tirane dhe pasi te marre licensen perkatese nga organi perkates tatimor.


#### **Neni 9**

Ortakët e shoqerise me krijimin e kesaj shoqerie pjesen e kapitalit te derdhur prej tyre nuk mund ta terheqin. Kjo mund te behet vetem pasi te nxirret bilanci i shoqerise per fitimin e realizuar.

#### **Neni 10**

Kuotat e çdo anetari perputhen me pjesen e tyre ne kapitalin e shoqerise. Kuotat e tij anetari i shoqerise mund t'ua ofroje te treteve. Anetaret e shoqerise kane perparesi per blerjen e kuotave perpara personave te trete jashte shoqerise. Ortaku qe deshiron te transferoje ose te shese kuotat e tij i drejton nje kerkese me shkrim Organit Administrativ duke saktësuar çmimin e shitjes, i cili duhet te jete i arsyeshem dhe te jete i njejte me ate qe do t'i ofrohet dhe nje personi te trete jashte shoqerise si dhe te dhenat e blesesit. Organi administrativ jep pergjigje brenda 30 diteve nga data e njoftimit dhe duhet t'ua transmetoje ortakeve te tjere kete kerkese te cilet duhet te japin nje pergjigje brenda 3 muajve. Edhe e drejta e perparesisë per transferimin ose shitjen e kuotave duhet te ushtrohet me shkrim duke ju drejtuar Organit Administrativ.

E drejta e perparesisë per transferimin ose shitjen e kuotave eshte ne proporcion me kuotat qe zoteron secili prej ortakeve ne kete shoqeri. Organi Administrativ pasi ka kaluar afati prej 3 muajsh, brenda 30 diteve i komunikon ortakut qe shet kuotat e tij vendimin e ortakeve te tjere per te blere te gjitha ose pjeserisht kuotat e tij. Ne rast se kuotat nuk shiten brenda shoqerise, atehere keto kuota brenda 90 diteve i ofrohen personave te trete jashte shoqerise. Transferimi dhe shitja e kuotave duhet te behen me akte noteriale dhe nje kopje e ketij akti duhet te depozitohet ne librin e Ortakeve. Po keshtu transferimi i kuotave ne rruge trashegimie behet sipas neneve 46, 47, 49 te ligjit 7638 date 19.11.1992. Te gjitha transferimet kane efekt mbi shoqerine qe nga momenti i regjistrimit ne librin e Ortakeve. Kuotat prej 1.000 leke jane te pandashme. Ne rastet e bashkepronesise veprohet sipas ligjeve.



### Neni 11

Emertimi i shoqerise tregtare, kapitali themeltar, emrat e administratoreve, si dhe emrat e Ortakeve duhet te jene te permendura ne te gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqeri dhe qe iu drejtohen te treteve. Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme dhe me permbajtjen perreth saj.

### Neni 12

Shoqeria vepron nen regjimin e prones private dhe merr persiper vete te drejtat dhe detyrimet kontraktore dhe jashtekontraktore. Ortaket e shoqerise drejtojne procesin per zhvillimin e aktivitetit te shoqerise si dhe per detyrimet qe ka shoqeria ndaj te treteve pa asnje kufizim.

Organet e shoqerise jane:

- 1- Asambleja e Ortakeve.
- 2- Keshilli Administrativ.

## ASAMBLEJA E ORTAKEVE

### Neni 13

Organi me i larte i shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve e cila mblidhet nga çdo anetar i shoqerise qe perfaqeson te pakten 10% te kapitalit te shoqerise. Antaret duhet te njoftohen 15 dite perpara dhe ne lajmerim duhet te jete shkruar vendi, ora dhe ceshtjet qe do te trajtohen.

Neqoftese Asambleja nuk eshte mbledhur sipas rregullave te caktuara ajo mund te marre vendim kur çdo anetar i shoqerise eshte prezent dhe nuk kundershton mbledhjen e Asamblese.

Çdo anetar i shoqerise ka te drejte te vere ne rendin e dites problemin qe ai deshiron. Per kete duhet te informohen anetaret 3 dite perpara.

## TE DREJTAT DHE KOMPETENCAT E ASAMBLESE

### Neni 14

Asambleja eshte e zakonshme dhe e jashtezakonshme.

1) **Asambleja e Zakonshme:** Mblidhet te pakten 1 here ne vit, brenda 4 muajve nga dita e mbylljes se veprimtarise. Ne kushte te vecanta Asambleja e zakonshme mund te mblidhet dhe brenda 6 muajve nga dita e mbylljes se veprimtarise se shoqerise.

Asambleja e zakonshme e ortakeve merr vendime te vlefshme si me poshte:

Ne thirrjen e pare ne pranine e ortakeve qe jane vete prezent ose te perfaqesuar nga persona te trete me prokure te posacme dhe qe zoterojne me shume se gjysmen e pjeseve te kapitalit themeltar.

Ne rast se nuk sigurohet kjo shumice, ne mbledhjen e dyte vendimet merren me shumicen e votave te dhena pavaresisht nga perqindja e kapitalit qe ato perfaqesojne.

Kompetencat e asamblese se Zakonshme:

Asambleja e Zakonshme e ortakeve ka kompetencat e meposhteme:

Ajo emerone administratoret, zevendesin, ekspertet dhe revizoret kontabel.

Ajo aprovon çdo lloj veprimi financiar qe me ligj dhe me marreveshje lihet ne kompetence te Asamblese.

Percakton shperblimin per administratoret, ekspertet, revizoret kontabel.

Ben lidhjen e kontratave per dhenie dhe marrje te drejtash ose ekskluzivitet per tregtimin dhe prodhimin e mallrave te shoqerise si dhe kontrata ne lidhje me organet shteterore per pjesmarrjen ne tender, ankande ose aktivitete te tjera te rendesishme.

Miraton marreveshjet midis shoqerise dhe nje prej administratoreve ose ortakeve te saj.

Ka te drejte te miratoje bilancin e shoqerise dhe te beje ndarjen e fitimit.

Vendos edhe per cdo ceshtje tjeter qe nuk sjell ndryshime ne statutin e shoqerise.

2) **Asambleja e Jashtezakonshme:** Thirret kur Organi Administrativ e sheh te arsyeshme ose kur kerkohet nga ortakët qe perfaqesojne 10% te kapitalit te shoqerise. Ne kete rast Organi Administrativ ka te drejte te vendose ditën e mbledhjes jo me larg se 15 dite nga dita e kerkeses.

Ne mbledhjen e Asamblese se Jashtezakonshme vendimet do te jene te vlefshme ne rast se ato do te merren nga ortakët qe perfaqesojne te pakten  $\frac{3}{4}$  (tre te katertat) e pjeseve te kapitalit themeltar.

Asambleja e jashtezakonshme e ortakeve ka kompetencat e meposhtme:

Te marre ne shqyrtim dhe ka te drejte te miratoje te gjitha ndryshimet e statudit.

Ajo ka te drejte te beje perjashtimin e nje ortaku nga shoqeria per rastet e parashikuara ne ligj si dhe ne rregulloren e brendshme te shoqerise.

Ben transferimin e kuotave te te tretet.

Si dhe çdo ceshtje tjeter qe nuk eshte ne kompetencen e Asamblese se Zakonshme.

Realizon blerjen, shitjen dhe transferimin e pasurive te paluajtshme te shoqerise etj.

Vendos në lidhje me çdo ceshtje te lidhur me pasurine e shoqerise, shitjet dhe blerjet nepermjet hipotekes, kredise, etj.

Vendos pjesemarrjen ne shoqeri te tjera.

#### Neni 15

Kur pjesemarrja ne asamble eshte normale vendimet qe merren brenda kufijve te kontrates se themelimit, Statutit e te ligjeve jane te detyrueshme per te gjithë, edhe per ata qe nuk kane marre pjese në diskutim edhe per ata qe nuk jane dakord.

Çdo ortak mund te perfaqesohet nga nje ortak tjeter qe nuk eshte administrator. Asnje i derguar nuk mund te perfaqesojë me shume se nje ortak.

Ne Asamblene e Ortakeve marrin pjese nese eshte e nevojshme per te dhene mendim eksperte, revizore etj.

#### Neni 16

Marrja e vendimeve te Asamblese, mbajtja e procesverbaleve dhe te gjitha dokumentat e tjera qe kane te bejne me te duhet te behen sipas legjislacionit ne fuqi per kete qellim.

### ADMINISTRIMI

#### Neni 17

Shoqeria administrohet nga 3 deri ne 7 administratore qe perbejne Keshillin Administrativ i cilei caktohet ne statutin e shoqerise dhe me pas nga Asambleja e Ortakeve. Administratorët qendrojnë ne detyre per nje periudhe 3 vjeçare, jane te riemerueshem, dhe ne rast se gjate kesaj periudhe shfaqen probleme paaftesie nga ana e secilit prej tyre, Asambleja e Ortakeve vendos shkarkimin e administratorit perkates duke treguar me fakte demin qe i eshte shkaktuar shoqerise nga paaftesia e tij pasi eshte dhene mendimi per kete dem nga specialistet perkates.

Keshilli Administrativ ka te gjitha kompetencat per te vepruar me te tretet ne emer te shoqerise dhe ne interes te saj ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji dhe Statuti i shoqerise u'a jep shprehimisht ortakeve.

Keshilli Administrativ ka te drejte qe te gjitha kompetencat e permendura me siper t'i ushtrojne se bashku apo veç e veç duke qene pergjegjes individualisht ose solidarisht, sipas rastit, ndaj shoqerise

apo te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Administratoreve nuk u lejohet te kontraktone ne çfaredo lloj forme, te marrin hua tek shoqeria, te japin pelqimin ne emer te saj, per paradhene si dhe te behen dorezanes apo te garantojne ne emer te saj angazhimet ndaj te treteve.

Keshilli zgjedh mes anetareve te tij:

Nje President te cilit i rezervohet firma dhe perfaqesimi ligjigjor ne gjykim i shoqerise;  
Nje Administrator te Deleguar te cilit i rezervohet pervec firmes dhe perfaqesimit ligjigjor te shoqerise ndaj te treteve dhe ne gjykim fuqite ne vijim: drejtimi i veprimtarise se shoqerise, perfaqesimi i shoqerise ndaj te treteve, nenshkrimi i kontratave per sherbime furnizimi, propozimi i realizimit te projekteve te reja sociale, pergatitja dhe mbajtja e kontabilitetit, permbushja e te gjitha veprimeve bankare te nevojshme dhe sidoqofte te gjitha fuqite e administrimit te zakonshem.

Keshilli Administrativ therritet te pakten 5 dite me pare nepermjet faxit dhe ne raste urgjence ky afat mund te ulet deri ne 3 dite. Vendos me shumicen e te pranishmeve dhe shperndahet me doreheqjen e Administratorit te Deleguar ose me doreheqjen e te pakten dy keshilltareve.

Asambleja mund te vendose lejimin e nje shperblimi ne favor te Administratorit per kryerjen e detyres pervec pagimit te shpenzimeve.

Aktualisht Administratore te shoqerise jane:

Z. Vilson Ahmenti President, shtetas shqiptar, lindur ne Fier, me 05.09.1951, banues Tirane, Rr. "Vaso Pasha" 14/23, me zotesi te plote juridike per te vepruar;

Z. Francesco Becchetti Administrator i Deleguar, shtetas italian, lindur ne Rome, me 31.08.1966, banues per detyren ne Rome, Piazza di Spagna 66, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar;

Z. Manlio Cerroni Keshilltar, shtetas italian, lindur ne Pisoniano (Roma), me 18.11.1926, banues per detyren ne Rome, Via del Poggio Fiorito 63, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Z. Andi Kondi Keshilltar, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane, me 27.05.1971, banues per detyren ne Tirane, Rr. "Deshmoret e Kater Shkurtit" n. 5, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.

#### Neni 18

Keshilli Administrativ mund te emeruje nje ose me shume drejtores per te kryer veprime te vecanta duke percaktuar fuqine e tyre brenda kufijve e duke e respektuar Statutin dhe ligjet ne fuqi dhe vendose dhenien e nje shperblimi ne favor. Detyrat e tyre do te percaktohen ne nje rregullore te brendshme te shoqerise.

#### Neni 19

Keshilli Administrativ ka liri te plote per drejtimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te shoqerise dhe mund te kryeje te gjitha llojet e veprimeve dhe çdo lloj marreveshje per realizimin e qellimeve te shoqerise duke perjashtuar rastet qe jane te parashikuara ne ligj dhe ne Statut qe i takojne Asamblese se Ortakeve.

#### Neni 20

Administratori i Deleguar ka te drejte te nenshkruajne per shoqerine, kontrata te ndryshme, per furnizime publike private, te ndermarre veprime gjyqesore per dhe ne emer te shoqerise, etj. Keshilli mund te jape prokura ne kufijte qe i lejon Asambleja e Ortakeve per kategori te caktuara veprimesh.

**COSTRUZIONI s.r.l.**  
Vicolo del Bottino n. 10  
00187 ROMA  
Part. IVA 07070201004

Administratoret janë të detyruar të mbajnë regjistrat e magazinimit të cilet vihen në dispozicion të Zyres Doganore për të mundësuar kryerjen e kontrolleve prej saj. Administratoret e shoqërisë janë të detyruar të mbajnë inventare të rregullta një herë në muaj. Raporti i administrimit, inventari dhe llogaritë vjetore, hartohen nga Administratoret.

## **PJESMARRJA NE VENDIME**

### **Neni 21**

Cdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në vendime si dhe disponon një numër votash të barabartë me pjesët e kapitalit themeltar që ai zoteron.

Një ortak mund të përfaqësohet nga një ortak ose nga një person tjetër me prokurë të posaçme.

## **ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE**

### **Neni 22**

Ortaket do të zgjidhin të gjitha mosmarreveshjet, që do lindin mes tyre apo mes ortakëve dhe shoqërisë dhe anasjelltas, që kanë lidhje me shoqërinë dhe aktivitetin e saj dhe me çdo aktivitet të lidhur me të dhe/ose ortakët e saj me mirekuptim mes njeri-tjetrit. Në rast se nuk arrijnë të zgjidhin mosmarreveshjet me mirekuptim atëherë ata do të referohen Qendres Shqiptare të Ndermjetesimit dhe Arbitrazhit për zgjidhje me arbitrazh, me një gjykatë arbitrazhi të përbërë nga tre arbitra, sipas rregullave dhe procedurave të kësaj Qendre. Secila nga palet do të zgjedhë një arbitër. Ortaket që nga ky çast bien dakort që arbitri i tretë i cili do të jetë dhe Kryetari i Trupit arbitral të jetë Av. Enyal Shuke lindur në Tiranë më 8.05.1967 me studio në Rr. Deshmoret e 4 Shkurtit, Sky Tower, n.64. Në rast se ndonjëra nga palet nuk arrijnë të zgjedhë arbitrin e saj brenda 15 ditëve nga kërkesa për arbitrazh, ai do të emërohet nga Qendra. Ligji i zbatueshëm do të jetë ai shqiptar. Vendi ku do të zhvillohet arbitrazhi do të jetë Tiranë.

## **MARREDHENIET E PUNES**

### **Neni 23**

Marredheniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe legjislacionit të punës

në fuqi. Shoqëria private merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të punësuarit janë të detyruar që të respektojnë Statutin e kësaj shoqërie dhe rregullat e brendshme të saj. Të punësuarit duhet të përgjigjen për dëmet që i shkaktojnë kësaj shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

## **KONFIDENCIALITETI, RUAJTJA E SEKRETIT**

### **Neni 24**

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet të bëhet publike përmbajtja e tyre për të tretet e të gjitha akteve dhe dokumentave që janë përcaktuar si të tilla nga administratoret e kësaj shoqërie.

## **EKSPERTET OSE REVIZORET KONTABEL**

### **Neni 25**

Kontrolli mbi veprimtarinë e Administratorit, veprimtarinë e tij si dhe gjithë aktivitetin e shoqërisë i besohet një eksperti ose revizori kontabel. Ky ekspert do të qendrojë në detyrë për atë sa përcaktohet me ligj dhe mund të rizgjidhet. Asambleja e Ortakëve cakton dhe shpërblimin përkatës kur nuk ka norma të vecanta ligjore.



## BILANCI DHE FITIMET

### Neni 26

Veprimtaria ekonomike e shoqerise do te mbyllet ne date 31 Dhjetor te çdo viti. Administratori merr masa per hartimin e bilancit dhe rezultatin ekonomik fitim - humbje dhe inventar. Pasi vecohen fondet si me sipër dhe paguhen detyrimet fiskale, te ardhurat qe mbeten ndahen midis ortakeve dhe mund te transferohen lirisht jashte shtetit sipas dispozitave perkatese ligjore.

### Neni 27

Ne rast se kapitali i shoqerise per shkak te humbjeve te realizuara rezulton me pak se kapitali themeltar, pronaret vendosin brenda 4 muajve per mundesine e prishjes se shoqerise.

## SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

### Neni 28

Ne rast se shoqeria priset per çdo lloj arsye Asambleja e Ortakeve percakton menyren e likuidimit, emeron nje ose me teper likuidatore dhe pergatit te gjitha dokumentet e nevojshme per ç'regjistrimin e saj nga Regjistri Tregtar.

## LIBRAT E SHOQERISE

### Neni 29

Po keshtu shoqeria ne baze te ligjit mban librat e meposhtem:

- 1) Libri i Ortakeve
- 2) Libri i Mbledhjeve
- 3) Libri i vendimeve te administratorit
- 4) Libri i mbledhjeve dhe vendimeve te eksperteve ose revizoreve kontabel.

Librat e mesiperm duhet te jene te ruajtura per 10 vjet e cdo faqe duhet te jete e vulosur.

## DISPOZITA TE PERGJITHSHME

### Neni 30

Persa eshte shprehur ne kete statut i referohemi ligjit 7638 dt 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare", Statutit dhe rregullores se brendshme te shoqerise. Çdo ndryshim behet ne te njejten menyre sic eshte nxjerre ky Statut dhe nuk prek personalitetin juridik te kesaj shoqerie.

\*\*\*\*\*

Per sa i perket pjeses se zakonshme presidenti lexon bilancin e ALBANIABEG AMBIENT Sh.p.k. te mbyllur me 31.12.2004.

Asambleja ne unanimitet aprovon pikat e rendit te dites dhe i jep mandat ortakut Znj. Liliana Condomitti, duke i dhene fuqi me te medha, per te marre pjese ne asamblene e zakonshme e ENERGJI Sh.p.k. sipas thirrjes.

Asgje tjeter, pasi u mblodhen per te vendosur dhe pasi askush nuk kerkoi te drejten e fjales, Presidenti deklaroi te mbyllur asamblene ne oren 13:00 pas redaktimit, leximit dhe nenshkrimit te ketij verbali.

PRESIDENTI

(Stefania Grigolon)

SEKRETARI

(Liliana Condomitti)

COSTRUZIONI s.r.l.  
Vicolo del Bottino n. 10  
00187 ROMA  
Part. IVA 07070201004